



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 21, datë 26.03.2025

**PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË HOTEL, 1, 3, DHE 4 KATE ME 1 KAT NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË
BASHKINË SHKODËR**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Z. Petrit Gjeçaj dhe Znj. Aida Gjeçaj, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë hotel, 1, 3, dhe 4 kate me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër, me zhvillues Z.Petrit Gjeçaj dhe Znj. Aida Gjeçaj.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 10 04 / 2026